



VENDIM

Nr. 115, Datë 08.07.2016

**MBI
PËRCAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 87 pika 2 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 8, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016 të Bordit të ERE, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.07.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë se fundit të energjisë elektrike:

Konstatoi se:

- Me Vendimin nr. 449, date 15.06.2016, Keshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë se fundit të energjisë elektrike.”
- Ne pjesën III, të VKM nr. 449, date 15.06.2016, Keshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë se fundit të energjisë elektrike.” parashikohet se : *Deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë se fundit sipas këtij Vendimi, ERE cakton për kohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të mundësisë se fundit.*
- Me VKM nr.244 dt 30.03.2016 janë miratuar “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”

- Ne VKM nr.244 dt 30.03.2016 është parashikuar se :*Detyrimi i shërbimit publik përfaqshin nder te tjere KESh sh.a. dhe OSHEE sh.a. ku kjo e fundit do te siguroje blerjen e energjise elektrike per qellime te shërbimit universal nga KESh sh.a.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a në cilesinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në 31.12.2016.
2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit sipas parashikimeve të Vendimit të Keshilli i Ministrave nr. 449, date 15.06.2016.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI